



Prishtinë, 10.07.2025
Kodi i ZRRE-së: V_2799_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRrE/DMK_V_2686_04_25** i datës 15.04.2025;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës 16.05.2025.

në seancën e mbajtur më datë 10.07.2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** Kundërshtimi i KESCO-s, ndaj Vendimit të DMK-së për konsumatorin N. G., me shifër DPR - 90130262, si i pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2686_04_25 i datës 15.04.2025.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 15.04.2025 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2686_04_25 me të cilin e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e konsumatorit N. G., lidhur me kontestimin e faturës me nr. 12240DGL – 90130262, në vlerë prej 697.30 € dhe korrigjimit financiar të dt. 10.01.2025 dhe e ka obliguar KESCO-n që konsumatorit t'i anulojë korrigjimin financiar në vlerë prej -90.53 € dhe të bëjë korrigjimin financiar të ri, në vlerë prej -114.61 €, duke e bërë shpërndarjen e kWh për periudhën kohore 09/2024 deri me 12/2024.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, Furnizuesi KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- KESCO-ja konstaton se shpenzimi i regjistruar në njehsorin me nr. 69076989 është i saktë. Mos faturimi për periudhën 09/2024 – 11/2024 nuk ka nënkuptuar matje jo të saktë. Korrigjimi është bërë sipas gjendjeve të regjistruara në njehsor, pasi që njehsori SMART e bën ruajtjen e të dhënave;
- Leximi i bërë në periudhën 12/2024 na jep gjendjen e saktë dhe gjendjet e ruajtura në njehsor për secilën periudhë, nuk ka arsye të bartet në periudhat e tjera dhe të bëhet shpërndarje e kWh për muaj të tjerë në mënyrë proporcionale.



- Departamenti për konsumatorë në KESCO, kërkon nga Bordi i ZRrE-së, pezullimin e Vendimit të DMK-së me nr. ZRrE/DMK_V_2686_04_25 i dt. 15.04.2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2025 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Kundërshtimin e KESCO-s të datës 05.06.2025; Vendimin e DMK-së të datës 06.05.2025; Vendimin e KESCO-s të datës 04.02.2025; Kërkesat e konsumatorit në KESCO; Ankesën e konsumatorit në DMK të ZRrE-së të datës 11.02.2025; Raportin mbi Kontrollimin – Pranimin e Grupit Matës me nr. 0079093; Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik me nr. 0012596, të dt. 05.05.2025; fotografitë e njehsorit; Transaksionet e konsumatorit, Rrjedhën e energjisë dhe Listat e Leximit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Kundërshtimi i KESCO-s **është i pabazuar**, sepse:

Në vështrim kronologjik të këtij rasti, Bordi ka gjetur se, me datë 30.12.2024, Departamenti i Faturimit në KESCO i ka dërguar konsumatorit faturën me nr. 12240DGL-90130262, në vlerë prej 697.30 €. Me datë 31.12.2024, konsumatori ka parashtruar ankesë në KESCO duke e kundërshtuar këtë faturë, nën dyshimet për faturim jo të saktë të energjisë elektrike me njehsorin me nr. 69076989. Pas shqyrtimit dhe analizimit të ankesës së konsumatorit, Departamenti për Kujdes ndaj Konsumatorëve në KESCO, lëshon një Vendim, me të cilin aprovohet ankesa e konsumatorit, dhe atë duke u bazuar në leximet softuerike, rrjedhë të energjisë elektrike dhe transaksione, ashtu që, konsumatorit i bëhet shpërndarje e kWh për periudhën 09/2024 deri 12/2024 dhe korrigjimi financiar rezulton të jetë në vlerë prej - 90.53€.

Me datë 10.02.2025, i pakënaqur me këtë Përgjigje, konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, duke i kontestuar faturat e periudhës dhjetor 2024 dhe janar 2025 dhe korrigjimin financiar të dt. 10.01.2025. Konsumatori i propozon DMK-së që ankesa të aprovohet, ashtu që faturat e kontestuar dhe korrigjimi financiar të rishqyrtohen.

Bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike dhe analizimit të listave të leximit konstatohet se punëtorët e autorizuar të KEDS për leximin e pikave matëse kanë bërë inspektime të rregullta mujore por që në periudhën 09/10/11/2024 kanë evidentuar se nuk kanë qasje në pikën matëse të konsumatorit, përkatësisht kanë evidentuar “Metter inside, Diaspora”. Rrjedhimisht, një gjendje e tillë faktike, u pamundëson punëtorëve të KEDS që ta lexojnë njehsorin dhe ta evidentojnë gjendjen reale të shpenzimeve mujore të konsumatorit. Po ashtu, duhet theksuar se, kjo është në kundërshtim me nenin 25 – Qasja në pronë të konsumatorit, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, e ku thuhet se: *1. “Konsumatori është i obliguar që të ju lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 28, 29 dhe 30 të Ligjit për Energji. 2. Nëse konsumatori nuk lejon qasje për leximin e pajisjeve matëse edhe pas marrjes së njoftimit me shkrim, energjia e furnizuar do të faturohet bazuar në*



mesataren e faturave gjatë tre (3) muajve të mëparshëm". Bordi thekson se, konsumatori ka vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë ligjore, sepse është dashur që të iu lejojë qasje punëtorëve të autorizuar të KEDS në pikën matëse të konsumatorit. Kësisoj, për periudhën kohore që punëtorët e autorizuar të KEDS nuk kanë pasur qasje në pikën matëse të konsumatorit, i njëjti është faturuar vetëm me taksa, e që kjo reflekton në faturën e periudhës dhjetor 2024 ne të cilën konsumatori është faturuar me kWh të grumbulluar e që kjo nuk mund të paraqet shpenzim real të konsumatorit. Në periudhën tjetër kontestuese, periudhën 01/2025 vërtetohet se konsumatori ka lexim të saktë të shpenzimeve mujore dhe se faturimi është bërë bazuar në shpenzimet reale.

Duke pasur parasysh ankesën e konsumatorit për faturim të lartë, me datë 10.02.2025 DMK kishte kërkuar nga KEDS që të bëjë inspektimin e pikës matëse si dhe shqyrtimin e saktësisë së matjes për njëhisorin elektrik nr. 69076989 me pajisje "ZERA". Po të njëjtën ditë ekipet e autorizuar të KEDS-it për shqyrtime kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë bërë shqyrtimin e njëhisorit me pajisje ZERA, dhe se bazuar në matjet e ofruar rezulton se gabimi në matje është 0.09%. Bordi e ka analizuar me kujdes këtë procesverbal dhe konstaton se gabimi në matje është brenda kufijve të lejuar të matjes të përcaktuar me Kodin e Matjes së OSSH e që është $\pm 2.5\%$.

Bordi më tej e ka shqyrtuar Korrigjimin Financiar nr. 106815DPR-90130262 të datës 10.01.2025, të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO në vlerë prej -90.53€, në të cilin është evidentuar si vijon: *"Korrigjimi i kWh për periudhën 09/2024-12/2024 bazuar në leximet softuerike dhe rrjedhën e energjisë elektrike"*, dhe ka gjetur se, KESCO-ja ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike ku thuhet se: 3. *"Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njëhisorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese"*, por që, ky korrigjim financiar nuk është i saktë, për shkak se, KESCO është dashur që të bejë shpërndarjen e kWh të faturuar për periudhën 09/2024 deri në periudhën 12/2024 kur edhe kemi lexim të saktë të shpenzimeve. Bazuar në këtë DMK konstaton se konsumatorit duhet ti behet korrigjimi në vlerë -114.61€ duke bërë shpërndarjen e kWh të faturuar për periudhën 09/2024 deri në periudhën 12/2024.

Tutje, duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, *"të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuar nga ZRRE-ja"*, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se i licencuari KESCO në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova konkrete.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Rregullën për Shkycjen, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s;
- Konsumatorit **N. G.**,
- Arkivit të ZRrE-së.